




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Prishtinë, 10 Korrik, 2020

Nr.

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT

Ndërmjet

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

Dhe

Komuna e Gjakovës

PRISHTINË, 2020

Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7/1 Mars 2019, duke u bazuar në nënin 8 të Rregullores (QKR), Nr. 06/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregullorën (QKR) Nr.m 07/2020 për Plotsimin dhe Ndryshimin e Rregullorës (QKR) Nr 06/2020, në nënin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), si dhe Ligjit Nr. 06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1/19 Mars 2020, palët nënshkruese lidhin këtë:

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT
“Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës”

Palët Nënshkruese

1. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e përfaqësuar nga Ministri i MEA-së (në tekstin e mëtejme MEA),

dhe

2. Komuna e Gjakovës e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna),

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit “Trajtimi i Deponisë Transfer në Komunën e Gjakovës” si dhe përcaktimi i obligimeve të MEA-së dhe Komunës së Gjakovës për realizimin e projektit në fjalë.

Neni 2
Vlera e projektit dhe mënyra e Bashkëfinancimit

1. MEA financon këtë projekt në vlerë prej: 400,000.00 € në vitin fiskal 2020.
2. Komuna e Gjakovës financon projektin nga kategoria e Mallra dhe Shërbime, në vlerë prej 20.000 euro. Mjetet e zotuarra të komunës së Gjakovës paguhet pasi që të paguhet mjetet nga MEA.

Neni 3
Obligimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit

8.2 Kopjen e Kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik së bashku me ofertën financiare, të verifikuar nga origjinali prej menaxherit të prokurimit të komunës.

8.3 Vendimi mbi emërimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimi nga ana e Komunës.

8.4 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimi mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara).

8.5 Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MEA.

8.6 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

9. Komuna është e obliguar të njoftoi MEA për rrjedhat e realizimit të projektit sipas progresit të punimeve deri në përfundim të projektit.

Neni 5

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1.Me pëlqimin paraprak të Ministres së MEA -së, dhe Kryetarit të Komunës, marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.

2. MEA -ja mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i ka përmbushur obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 6

Zgjidhja e marrëveshjes

Palët janë pajtuar në mes vete që kjo marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 7

Numri i kopjeve

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy kopje, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 8


Pronësia e projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kaloj në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 9
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Blerim Kuçi,
Ministër i MEA-së



Ardian Gjini,
Kryetar i Komunës së Gjakovës



